




Nr. 3370 i Prot.
Tiranë, 31.10.2018



Nr. 406 i Prot.
Tiranë, 31.10.2018

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KUVENDIT TË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Preambul

Kuvendi i Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, të cilat në vijim do të quhen Palë;

1. Me qëllim fuqizimin e parlamentarizmit në Shqipëri dhe rritjen e kontributit të botës akademike në procesin ligjvënës dhe të forcimit të shtetit të së drejtës;
 2. Me qëllim institucionalizimin e dialogut ndërveprues shkencë-politikë midis veprimtarisë parlamentare dhe të asaj akademike;
 3. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së mendimit shkencor shqiptar në kodifikimin e së drejtës në formën e këshillimit, oponencës dhe relacioneve si dhe përmes faktorizimit të drejtpërdrejtë të botës akademike në hartimin e akteve ligjore;
 4. Me qëllim mbështetjen institucionale në përmbushjen e funksioneve të *Palëve* në të mirë të progresit shtetëror e shkencor,
- Nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi:

Neni 1

Baza ligjore

Për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje *Palët* u referohen këtyre dokumenteve:

1. Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 3, 14, 57-58;
2. Akteve ligjore-bazë që rregullojnë veprimtarinë e *Palëve*;
3. Dokumenteve themelore të nënshkruara dhe pranuar nga autoritetet e shtetit shqiptar për përgjegjësitë e ndërsjellta të shkencës dhe politikës në kuadër të *Procesit të Berlinit* për sisteme shkencore të përmirësuara në Ballkanin Perëndimor (rikonfirmuar në *Deklaratën e Vjenës*, 22-24 maj 2016).

Neni 2

Detyrime kushtetuese

1. *Palët* bashkëpunojnë me përparësi për rregullimin ligjor të statusit të gjuhës shqipe në funksionet e saj publike në përputhje me nenin 14 pika 1 dhe 7 të Kushtetutës;
2. *Palët* njohin përgjegjësitë e njëra-tjetrës dhe ofrojnë bashkëpunim përparësor për të gjitha çështjet ligjvënëse që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar dhe me përrurimin e imazhit të shtetit shqiptar brenda dhe jashtë vendit;

3. *Palët* konsiderojnë se është në misionin e tyre të ofrohen për bashkëpunim në procesin e euro-integrimit.

Neni 3

Dialogu i institucionalizuar

1. *Palët* zotohen për të institucionalizuar përmes kësaj marrëveshjeje dialogun midis politikës dhe shkencës, në këto drejtime themelore:

- Për të faktorizuar praninë e mendimit shkencor akademik në procesin ligjvënës nëpërmjet njohjes së të drejtës së propozimit të projekt-akteve juridike që kanë të bëjnë me funksionet institucionale dhe amendime të tyre;

- Përmes oponencave me shkrim dhe me gojë të nismave ligjore të propozuara nga institucione të tjera, si dhe përmes pranisë së drejtpërdrejtë akademike në debatet parlamentare në komisione;

- Përmes ftesave për ekspertizë dhe interpretim në institucionin ligjvënës;

- Përmes këshillimeve në forma të tjera, duke përfshirë audiencat e përbashkëta.

Neni 4

Mekanizma këshillimorë të bashkëpunimit

1. *Palët* bien dakord që të krijojnë *mekanizma këshillimorë*, në përputhje me *Deklaratën e Nismës Ndërqeveritare për Ballkanin Perëndimor*, nënshkruar në Vjenë më 22-24 maj 2016.

- Për rritjen e pjesëmarrjes intelektuale në procesin ligjvënës;

- Për integrimin institucional të Akademisë së Shkencave në funksionet e saj themelore si aktor dhe faktor për shtetin e së drejtës;

- Për shkencorizimin në proces të akteve të ligjvënies.

2. Për sa më sipër *Palët* bien dakord për krijimin e një *organizmi këshillimor* që funksionon pranë Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, me pjesëmarrjen e akademikëve, anëtarë të Asamblesë së Akademisë së Shkencave. Në këtë organizëm këshillimor herë pas herë ftohen edhe ekspertë të tjerë të fushave gjegjëse.

Neni 5

Zotime të tjera të *Palëve*

Kuvendi i Shqipërisë i ofron Akademisë së Shkencave:

a) Mundësinë për të kontribuar në procesin e kontrollit parlamentar;

b) Rol të drejtpërdrejtë në ushtrimin e detyrave të shtetit shqiptar në kuadër të diplomacisë shkencore dhe kulturore;

c) Bashkëpunim në organizimin e konferencave dhe veprimtarive të tjera të këtij lloji për çështje me interes publik për reforma të rëndësishme, projektligje, të cilat kërkojnë konsultim të gjerë;

ç) Informacion në dobi të procesit të kërkimeve shkencore e akademike, që lidhen me veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë dhe të organeve të tij;

d) Ftesa për konferenca dhe veprimtari të tjera parlamentare të organizuara nga Kuvendi i Shqipërisë;

dh) Mundësi konsultimi të bazave të të dhënave të Kuvendit të Shqipërisë;

e) Bashkëpunim në realizimin e publikimeve dhe botimeve në fushën e parlamentarizmit;

ë) Leksione me qëllim edukimin mbi fushën e parlamentarizmit në Akademi.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë i ofron Kuvendit të Shqipërisë:

a) Bashkëpunim për organizimin e konferencave dhe veprimtarive të tjera të këtij lloji për çështje me interes publik, të cilat kërkojnë konsultim të gjerë;

b) Pjesëmarrje të anëtarëve të Asamblesë së saj në debatet parlamentare në komisionet e përhershme përmes ekspertizës profesionale;

c) Pjesëmarrje me analiza dhe punime të përbashkëta në projekte kërkimore;

ç) Bashkëpunim në realizimin e publikimeve dhe botimeve në fushën e parlamentarizmit;

d) Shkëmbim botimesh, raportesh, relacionesh;

dh) Organizim veprimtarish profesionalizuese me interes për deputetët dhe administratën e Kuvendit të Shqipërisë;

e) Mundësinë për hyrje të lirë në publikimet e numerizuara të Akademisë së Shkencave.

Neni 6

Efektet buxhetore

Kostot që rrjedhin nga përmbushja e detyrimeve të përcaktuara nga kjo marrëveshje u ngarkohen përkatësisht palëve pjesëmarrëse, brenda fondeve buxhetore të përcaktuara. Kjo nuk ndikon pagesat mbi ushtrimin e detyrave funksionale administrative, institucionale, pedagogjike dhe botuese.

Neni 7

Vlefshmëria


Kjo marrëveshje është e vlefshme pa afat të parashkruar, deri në përgatitjen dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje të re, që shpreh vullnetin e *Palëve*.

Marrëveshja u nënshkrua sot, më 31 tetor 2018, në gjuhën shqipe, në katër kopje, dy për secilën *Palë*.

Kuvendi i Shqipërisë

Kryetari

Gramoz RUCI



Për Akademinë e Shkencave

Sekretari shkencor

Akad. S. Vasil TOLE

